



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
MINISTARSTVO JAVNE ADMINISTRACIJE
MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION

Ref. 06/096/2017

Departamenti për Organizata Jo-Qeveritare Ministria e Administratës Publike, në pajtim me Nenin 9 paragrafi 9 lidhur me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, si dhe lidhur me nenin 18 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ QRK-NR. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Organizatave Joqeveritare, duke vendosur sipas kërkesës së Organit Kompetent të Sigurisë, Departamenti për OJQ më datë 13. Shkurt 2017, merr këtë:

V E N D I M

1. Pezullohet veprimtaria e Organizatës Jo-Qeveritare „Airsoft Club Vukovi”(ACVukovi), me numër regjistrimi 511685-5 e regjistruar me datë 11.12.2017
2. Vendimi mbi Pezullimin e Veprimtarisë së kësaj organizate vlen deri në vendimin tjetër.

Arsyetim

Duke u bazuar në kërkesën e Organit Kompetent të Sigurisë, nr .i prot. 01/0025,për Pezullimin e Veprimtarisë së OJQ-së „ Airsoft Club Vukovi”(AC Vukovi),me numër regjistrimi 5115855-5 e regjistruar me datë 11.12.2015 dhe

Kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të Organizatës Jo-qeveritare për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë së kësaj Organizate.

Departamenti për OJQ/MAP vendosi për Pezullimin e veprimtarisë së OJQ-së „Airsoft Club Vukovi”(AC Vukovi). Vendimi është bazuar në informacionet e institucioneve kompetente të sigurisë se ekziston dyshimi i bazuar që veprimtaria e OJQ-së “Airsoft Club Vukovi”(AC Vukovi), bie ndesh me interesat e sigurisë , nuk përkon me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht ka bërë shkelje edhe të normave juridike të statutit në bazë të cilit është regjistruar.

Departamenti për OJQ Ministria e Administratës Publike, pas shqyrtimit të kërkesës të parashtruar nga Organi Kompetent i Sigurisë dhe administrimit të provave materiale konstatoj se aktivitetet e zhvilluara nga kjo Organizatë nuk janë në harmoni me normat e statutit të saj dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ, andaj vendosi për pezullimin e Veprimtarisë së Organizatës Airsoft Club Vukovi .

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë në mbështetje të nenit 16 Paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe nenit 18 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ QRK-NR. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Organizatave Jo-qeveritare, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë përmes Departamentit për OJQ ,në Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve pranë MAP në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Divizioni për Regjistrimin e OJQ-ve , Departamenti për OJQ në Ministrinë e Administratës Publike.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi ju dërgohet:

- 1.Përfaqësuesit autorizuar të OJQ
- 2.Parashtruesit të kërkesës
- 3.Administratës Tatimore të Kosovës,
- 4.Doganave të Republikës së Kosovës

Prishtinë,

Datë 13Shkurt 2017

